VENDIM
Nr. 565, datë 9.8.2006

PËR MBROJTJEN E SHTRESAVE NË NEVOJË, NGA RRITJA E ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

(Ndryshuar me VKM nr. 46, datë 31.1.2007; nr. 238, datë 7.4.2010)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 1 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", dhe të ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin për efekt të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, për nivelin e konsumit 200 kW/orë, për:

a) familjet, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, si dhe familjet, që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuar, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-it, sipas pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", kur personi me aftësi të kufizuar është kryefamiljar dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat;

b) kryefamiljarët, që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror, dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar në sektorin publik ose të vetëpunësuar në sektorin privat;

c) *kryefamiljarët, që përfitojnë pension pleqërie, shtetëror, ose që përfitojnë pension pleqërie, fshati, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes, të punësuar në sektorin publik apo të punësuar në subjekte, juridike fizike, e private a të vetëpunësuar në sektorin privat, brenda territorit të Republikë së Shqipërisë.*

ç) familjet e punonjësve buxhetorë, me pagë mujore bruto nën 35 mijë lekë në muaj, kur punonjësi është kryefamiljar dhe nuk ka asnjë anëtar të familjes të vetëpunësuar në sektorin privat.

2. Kompensimi për familjet, që do të kompensohen sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet vetëm për një kontratë të energjisë elektrike dhe jepet vetëm një herë për një familje, pavarësisht se ato mund të kenë në përbërje edhe të punësuar të tjerë në sektorin buxhetor, që kanë pagë nën 35 mijë lekë, apo persona të paaftë a invalidë, persona që përfitojnë pension pleqërie, invaliditeti apo ndihmë ekonomike.

3. Përfituesit, që kompensohen për të përballuar rritjen e çmimit të energjisë elektrike, sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të përcaktohen nga institucionet përkatëse ku përfituesi merr pagën, pensionin dhe përfitimet e tjera, kundrejt deklarimit personal të përfituesit. Marrja e përfitimit pa deklarim dhe kundrejt deklarimit të rremë përbën shkelje administrative, përkatësisht, për dhënësin dhe për përfituesin e kompensimit. Në këtë rast institucioni përkatës zbaton dispozitat ligjore në fuqi.

4. Përfituesi i kompensimit, në zbatim të pikës 3 të këtij vendimi, detyrohet ta kthejë përfitimin e padrejtë dhe përjashtohet përgjithmonë nga e drejta e përfitimit të kompensimit për energjinë elektrike.

5. *Masa e kompensimit, për çdo përfitues, është 640 (gjashtëqind e dyzet) lekë në muaj. Efekti financiar i shtesës së kompensimit për çdo përfitues të përballohet nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2010, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.*

6. Rregullat e veçanta të përfitimit të pagesës dhe të zbatimit të skemës së kompensimit

përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave, të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2006.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA